



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 2264/Prot.

27

Tiranë, më 27. 8 .2024

V E N D I M

Nr. 20 , datë 27. 8 .2024

Për

“MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 3400-3800 MHZ” DHE NJOFTIMIT PËR TENDER PUBLIK (FTESË PËR OFERTË), ME REF. AKEP/3400-3800MHZ/2024”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Tomi Frashëri	Kryetar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Evblina Taçi, në mbledhjen e datës 27.08.2024, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe Ligjit nr. 8480 datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Grupit të Punës, shqyrtoi kërkesën me objekt:

Miratimin e dokumentit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz” dhe Njoftimit për tender publik (Ftesë për ofertë), me Ref. AKEP/3400-3800MHz/2024.

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 6, 7, 8, 68 dhe 69 të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

2. Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
3. VKM nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar me VKM nr. 501/2010.
4. VKM nr. 1187 datë 24.12.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” (PKF).
5. Planin e Përdorimit të Frekuencave (PPF), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7 datë 06.09.2023.
6. VKM nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit”.
7. Rregullore e brendshme e Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të KD të AKEP, e ndryshuar.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Shkresa nr. 4215/1 prot., datë 07.06.2024, e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.
2. Dokumenti e Tenderit dhe Njoftimit për tender publik, me Ref. AKEP/3400-3800MHz/2024, të hartuara nga Njësia e Hartimit të dokumentave;
3. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 3 datë 07.02.2024, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”. Procedura e këshillimit publik u zhvillua nga data 07.02.2024 deri në datën 07.04.2024.
2. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin 10 datë 07.05.2024, ka miratuar qëndrimin e AKEP për komentet/sugjerimet e paraqitura gjatë këshillimit publik të dokumentit “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”.
3. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin 11 datë 07.05.2024, ka miratuar propozimin për Ministrin, pas këshillimit publik të dokumentit “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz”.
4. Me shkresën nr. 2260/20 prot. datë 09.05.2024, AKEP i ka dërguar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë propozimin e miratuar me VKD nr. 11 datë 07.05.2024.
5. Me shkresën nr. 4215/1 prot., datë 07.06.2024, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ka miratuar kufizimet dhe procedurën për dhënien e të drejtave të përdorimit të frekuencave në brezin 3400-3800 MHz, si më poshtë:
 1. AKEP të vijojë procedurën e konkurrimit publik për dhënien e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz, sipas ndarjes së propozuar:
 - Spektri i disponueshëm për këtë tenderim është 280 MHz.
 - Madhësia minimale e bllokut: 40 MHz.
 - Madhësia maksimale e bllokut: 80 MHz.
 - Mënyra e përdorimit të tij do të jetë TDD (Time-Division Duplexing).

2. Numri maksimal i Autorizimeve Individuale për përdorimin e frekuencave të brezit 3400-3800 MHz, për spektrin e disponueshëm për procedurën e konkurrimit, është 5 (pesë), për të drejtë përdorimi sipas blloqeve më poshtë:

Bloku	Sasia në MHz	Pozicioni në spektër
A	80 MHz	3420-3500 MHz
B	80 MHz	3720-3800 MHz
C	40 MHz	* Brenda brezit 3500-3720 MHz
D	40 MHz	
E	40 MHz	

3. Të ndiqet procedura e përcaktuar në VKM nr. 1252 datë 10.09.2008 i ndryshuar, "Procedurë e hapur" me raunde sipas skemës së propozuar.
4. Vlera minimale e pranueshme për ofertuesit për dhënien e një autorizimi individual për përdorimin e frekuencave në brezin 3400-3800 MHz, të jetë:
- Jo më pak se 3,624,000 Euro, për një të drejtë përdorimi për bllok me 80 MHz.
 - Jo më pak se 1,812,000 Euro, për një të drejtë përdorimi për bllok me 40 MHz.
5. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit Individual të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet. Autorizimi individual mund të zgjatet ose rinovohet sipas legjislacionit në fuqi për komunikimet elektronike. Koha e fillimit të shfrytëzimit të frekuencave të jetë jo më vonë se 6 muaj nga data e pajisjes me Autorizim Individual.
6. Kërkesat për mbulimin, sipas propozimit të AKEP.
7. Për kushtet teknike për Autorizimin Individual të aplikohen përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave.
8. Kriter i vlerësimit të ofertave të vlefshme, të jetë çmimi i ofertës sipas formulës së mëposhtme:
- $$Pox = 100 \times Cox / Çomax$$
- Ku: Pox - [Pikët e një oferte të dhënë (x) në varësi të çmimit të ofertës]
Cox - [Çmimi i ofertës së dhënë]
Çomax - [Çmimi maksimal i ofertave]
9. Mënyra e pagesës: Pagesë me 2 këste, sipas propozimit të AKEP.
10. Bazuar në parashikimet e shkronjës g) të pikës 3.3, të Kreut III "Zhvillimi i procedurave" të VKM nr. 1252/2008, të ndryshuar, në ftesën për ofertë/dokumentin e tenderit që publikohet nga AKEP, të jepet informacion mbi kërkesat për sigurinë e rrjeteve 5G që duhet të mbahen parasysht nga ofertuesit.
8. Në zbatim të Urdhrit nr. 93 datë 19.06.2024 "Për ngritjen e njësisë së hartimit të dokumentit të tenderit për dhënien në përdorim të frekuencave në brezin 3400-3800 MHz", Njësia ka përgatitur dokumentin e Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz" dhe Njoftimin për tender publik (Ftesë për ofertë), me Ref. AKEP/3400-3800MHz/2024 dhe ka pasqyruar në këto dokumente kufizimet dhe procedurën e miratuar nga Ministri.

ARSYETON:

1. Bazuar në nenet 6, 7 dhe 8, të Ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar, AKEP është autoriteti i vetëm rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, përgjegjës për të nxitur/promovuar konkurrencën efçente me qëllim përdorimin e frytshëm të frekuencave, për kryerjen e procedurave të përcaktuara sipas këtij ligji për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, pas miratimit përkatës dhe për lëshimin e autorizimeve individuale për përdorimin e brezave të frekuencave, sipas Planit Kombëtar të Frekuencave dhe Planit të Përdorimit të Frekuencave.
2. Në nenin 5, pika 2 dhe nenin 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 636/2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit”, përcaktohet qartësisht objektivi strategjik për nxitjen e administrimit dhe përdorimit efçent të spektrit radio, për të përmbushur në kohë dhe më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike, si dhe përmirësimi i fleksibilitetit në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja.
3. Dokumentet e paraqitura për miratim, janë në përputhje me përcaktimet e neneve 6, 7, 8, 68 dhe 69 të Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, Kreun II dhe Kreun III, të VKM nr. 1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar Planin Kombëtar të Frekuencave, Planin e Përdorimit të Frekuencave dhe vendimet/rekomandimet specifike të CEPT/ITU.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës gj), të nenit 8, pikës 1, të nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr. 34/2017, K.Pr.A, pikës 2.3, të Kreut II, të VKM nr. 1252/2008, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, duke çmuar rëndësinë e vijimit të procesit, interesin publik dhe përputhshmërinë ligjore, Këshilli Drejtues i AKEP;

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin e Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 3400-3800 MHz” dhe Njoftimin për tender publik (Ftesë për ofertë), me Ref. AKEP/3400-3800MHz/2024, të cilët jepet bashkëlidhur.
2. Njoftimi për Tender të botohet një herë në Gazeta Kombëtare dhe një herë në Gazeta Ndërkombëtare.
3. Ky vendim, dokumenti i Tenderit dhe Njoftimi për tender, të publikohen në faqen e internetit të AKEP.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Tomi Frashëri

Lorenc Bako

Bleron Dokle

Armer Juka

Adresa: Rr. “Rëshit Collaku”, Tiranë, Tel. + 355 4 2259 571 Fax: + 355 4 2259 106 www.akep.al; info@akep.al